

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**BEAUTY SKINCARE**

Sot, më datë 24.03.2022, personalisht:

- **Aurel HOXHA**, i biri i Demir-it, i datëlindjes 24.03.1995, shtetas shqiptar, lindur ne Fier dhe banues ne Rr.Vasil Ndini Bare, Nr.21, Qender Drize, Fier, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare BEAUTY SKINCARE Sh.p.k dhe
- **Ardit HOXHA**, i biri i Demir-it, i datëlindjes 15.12.1997, shtetas shqiptar, lindur ne Fier dhe banues ne Rr.Vasil Ndini Bare, Nr.21, Qender Drize, Fier, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare BEAUTY SKINCARE Sh.p.k.

Përpilojnë këte akt themelimi të shoqërisë tregtare **BEAUTY SKINCARE sh.p.k**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojnë Shoqerinë Tregtare BEAUTY SKINCARE SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri BEAUTY SKINCARE SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit BEAUTY SKINCARE SH.P.K dhe me emrin tregtar BEAUTY SKINCARE. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4 Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Import eksport, tregtim me shumicë e pakicë, në dyqane fizike dhe/ose online, të artikujve të ndryshëm kozmetike, estetike dhe të mirëqënieve personale.

## **NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Bajram Curri, Godina AGIMI, H.19, Ap.339, Njesia Administrative nr.5, Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

## **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar eshte 100.000 ( njeqind mijë ) Lek dhe zotërohet nga ortaket themelues.

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: 100.000 leke

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 2.

## **NENI 7**

Ortaket themelues e Shoqërisë Tregtare “BEAUTY SKINCARE” Sh.p.k zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- Aurel HOXHA pjesemarrja ne perqindje 50 %, I kuotë, lloji i kontributit ne para, 50.000 leke
- Ardit HOXHA pjesemarrja ne perqindje 50 %, I kuotë, lloji i kontributit ne para, 50.000 leke.

## **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Ortakeve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 9 Administratori**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Zj. Kamila Gjin GJONI, e datelindjes 24.01.1994.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përrputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjisacionin në fuqi.

## **NENI 10**

Oratket mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 11

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

## NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

## NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u get sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

### ORTAKET THEMELUES

Aurel HOXHA



Ardit HOXHA

